



Republika e Kosovës -Republic of Kosovo- Republika Kosova
Komuna Obiliq- Obiliq Municipality-Opština Obilič



KOMUNA E OBILIQIT
ZYRA E PROKURIMIT

KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlozës

K O N T R A T

Ë

Nr. XIII-506

Data 07.12.2021
Datumi

Nr	Titulli I Projektit
1.	Bartja e nxënësve nga fshati Shipitullë në Graboc të Epërm dhe bartja e nxënësve nga fshati Hade në Palaj

001/2021

Dhjetor/2021
Obiliq

KONTRATA

**Komuna e Obiliqit,
rr. „Hasan Prishtina”15000 Obiliq Republika e KOSOVËS**

(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**Kastrioti SH.P.K., Rr.Hasan Prishtina - Komuna e Obiliq, 15000, Komuna e Obiliqit
810386624 përfaqësuar nga :Mehmetali Hasani drejtor**(në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën
tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara më poshtë:

Sigurimi I veturave zyrtare

Nr. Identifikues: **OB614-21-9533-2-3-6** & Numri i brendshëm **614 21 001 236**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës ka të bëjë me Bartjen e nxënësve nga fshati Shipitullë në Graboc të Epërm dhe Hade në Palaj

-Sipas Aneksit I

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën: **07.12.2021** dhe përfundon mbrenda 119 ditëve pune

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **[1]** ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i **[kryrjes së punëve]** do të jetë në Shipitullë në Graboc të Epërm dhe Hade në Palaj

1.5 Incotermii aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **8 132,46€**, tetmi e njëqind e tridhjet e dy euro 46/100 . euro

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Për t'i marrë pagesat, OE duhet t'i përcjellë Autoritetit Kontraktues

➤ Fatura (Origjinali i faturës në tre kopje) do t'i dërgohen direkt Autoriteti Kontraktues

Fatura duhet të përmbajë të gjitha informatat e OE si dhe informatat e mëposhtme :

- a) Numrin e Faturës dhe datën
- b) Titulli i kontratës dhe numrin
- c) Numri i rexhistrit të biznesit dhe numrin fiskal
- d) Adresën e livrimit në vendndodhje;
- e) Përshkrimin e mallrave dhe sasia
- f) Numri i xhirollogarisë
- g) Çmimin për njësi dhe shumën totale të pagueshme në Euro; e nënshkruar dhe e vulosur.

- a) Raportin nga menaxheri i projektit i AK dhe Çfarëdo dokumenti tjetër informativ që kërkohet nga Autoriteti Kontraktues.

Ç'do faturë duhet pas verifikimit të menaxherit të kontratës ti dërgohet Autoriteti Kontraktues për të bërë pagesën, dhe të gjitha këto duhet të adresohen tek : **Komuna e Obiliqit Rr. Adem Jashari, 15000 Obiliq.** zyra pritëse.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

Në rast se kontraktori nuk ia arrinë të furnizoj apo kryej punën për sasinë e specifikuar , atëherë ai është përgjegjës/e të plotësoj mungesën. Autoriteti Kontraktues nuk obligohet të paguaj mallrat,apo punët përderisa të mos plotësohet mungesa.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6. Kualiteti

6.1 Kualiteti i [furnizimeve punëve apo shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në aneksin 1. specifikimet teknike të detyrueshme si në Dosjen e Tenderit.

7.1 Garancioni do të mbetet përgjegjësi e OE

Në bazë të nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr.04/L-179 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Transportin Rrugor, nenit 9 të Rregullorës Komunale për Transportin Rrugor në territorin e Komunes së Obiliqit, DSHPE e lëshon këtë:

7.2 Kontraktuesi garanton që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe në material. Kontraktuesi garanton edhe që asnjë nga furnizimet apo pjesët nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria.

Neni 7.3 Përgjegjësia mbi Defektet

7.3.1 Po ashtu për sigurimin e cilësisë së shërbimeve, Operatori Ekonomik mban përgjegjësi duke u bazuar në licencën

Në bazë të nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr.04/L-179 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Transportin Rrugor, nenit 9 të Rregullorës Komunale për Transportin Rrugor në territorin e Komunes së Obiliqit, DSHPE e lëshon këtë:

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

9.2. AK. me vendim do të cakton Menaxherin e projektit i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

-Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

-Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrinei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *[Shqip]* ⁵ në katë origjinale, tre origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Mehmetali Hasani	Emri:	Sherif Hoti
Pozita:	Drejtor	Pozita:	ZPP
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07-12-2021	Data:	07-12-2021
Vula:		Vula:	

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: OB614-21-9533-2-3-6

Titulli i kontratës: **Bartja e nxënësve nga fshati Shipitullë në Graboc të Epërm dhe bartja e nxënësve nga fshati Hade në Palaj (ri-shpallje)**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e

saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura,

pa rezervë apo kufizim:

1 Bartja e nxënësve nga fshati Shipitullë në Graboc të Epërm dhe bartja e nxënësve nga fshati Hade në Palaj (ri-shpallje)

3. Çmimi total i tenderit është: **8 132,46 EUR**

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 30 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në

konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se

të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se

partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të

secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten

në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e

mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të

gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si

rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nesh nëse e bën këtë.

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Bartja e nxënësve nga fshati Shpitullë në Graboc të Epërm dhe bartja e nxënësve nga fshati Hade në Palaj

1. Fëmijët nxënës, duhet të mirren me automjet nga hyrjet e shtëpive të tyre në Shpitullë dhe të derdhen në oborrin e shkollës në Grabocin e Epërm, për çdo ditë mësimi për ndërrimin përkatës dhe të kthehen pasi ta kenë përfunduar mësimin nga oborri i shkollës në Graboc të Epërm dhe të barten gjër në hyrje të shtëpive të tyre.

2. Nxënësit duhet të jenë në oborrin e shkollës 15 min(pesëmbëdhjetë minuta) para të fillojë mesimi në ndërrimin përkatës.

3. Për kthimin e fëmijëve në shtëpi automjeti duhet të jetë 15min(pesëmbëdhjetë min) në oborrin e shkollës para se të përfundojë mesimin për ndërrim përkatës.


4. Shërbimi i bartjes së nxënësve konsiderohet se është realizuar për një ditë mësimi për një ndërrim përkatës, kur nxënës barten me automjet nga fshati Shpitullë deri në shkollën e Grabocit të Epërm dhe kthehet nga shkollën e Grabocit të Epërm në fshatin Shpitullë.


5. Numri i ulësve për fëmijë në automjet duhet të jetë minimum 9 (nëntë) ulës. Ngasësi i automjetit(shoferi) me rastin e hyrjes së fëmijëve në automjet dhe daljen nga automjeti, është i obliguar t'u ofroj ndihmë.

nr.	Përshkrimi	Nr. Nxënësve	KM	ditë	Sasia	Çmimi njësi DDP[1] - €	Shuma
1	Bartja e 3 nxënësve në ndërrimin e paraditës në relacionin Shpitullë deri në shkollën e Grabocit të Epërm dhe anasjelltas për çdo ditë mësimi, km në dy drejtimet 10.40 km 119 ditë mësimi sipas kalendarit shkollor.	3	10.40	119	1237.60	2.55 €	3,155.88 €
2	Bartja e 5 nxënësve në ndërrimin e pasditës në relacionin Shpitullë deri në shkollën e Grabocit të Epërm dhe anasjelltas për çdo ditë mësimi, km në dy drejtimet 10.40 km 119 ditë mësimi sipas kalendarit shkollor	5	10.40	119	1237.60	2.55 €	3,155.88 €
3	Bartja e 5 nxënësve në ndërrimin e pasditës në relacionin Hade deri në shkollën e "Fazli Grajqevci" në Palaj dhe anasjelltas për çdo ditë mësimi, km në dy drejtime janë 6km, dhe 119 ditë mësimi sipas kalendarit shkollor.	5	6.00	119	714.00	2.55 €	1,820.70 €
TOTALI :							8,132.46 €

Vrejtje:

- Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës., oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjëshme
- Në çmim të përfshihen të gjitha taksat e aplikuar në Kosovë, duke llogaritur edhe tvsh-në
- Operatorët Ekonomik me Çmime Jo-normalisht të ulët do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.
- Nëse ndodhë ndonjë gabim në plotësimin e paramasës AK nuk mbanë përgjegjësi.

Identifikim i operatorit ekonomik (oe)	
Emri i kompanisë:	KASTRIOTI SH.P.K
Adresa e plotë	HASAN PRISHTINA - OBILIQ
Përfaqësuar nga:	
Emri dhe mbiemri :	MEHMETALI HASANI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi:	
data:	01.12.2021
Vula	



AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ, RR.ADEM JASHARI, 15000, OBILIQ,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: OB614-21-9533-2-3-6

Nr i brendshëm: 614 21 001 236

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: Kastrioti SH.P.K., Rr.Hasan Prishtina - Komuna e Obiliq, 15000, Komuna e Obiliqit, Kosovë

E-mail: kastrioti.shpk@outlook.com

Personi kontaktues: Mehmetali Hasani

Telefoni: 044114815

Faxi:

Numri fiskal: 810386624